



INXHINIERI E ENERGJISË

Bachelor, &
Master

I have not failed. I've just
found 10,000 ways that
won't work.

Thomas Edison




Invert-Anlage



INXHINIERI E ENERGJISË

Programet Bachelor Inxhinieri e Energjisë dhe MSc Inxhinieria e Energjisë dhe Mjeditë ofrojnë arsim profesional në këtë fushë të rëndësishme të studimit. Këto dy programe trajtojnë Sistemet Elektroenergjetike, energjinë konvencionale, të ripërtërishme duke përfshirë edhe eficiencën e energjisë. Programet i mundësojnë monitorimin dhe kontrollimin e energjisë nga prodhimi deri te konsumi. Sistemet Elektroenergjetike kanë aplikime të gjera në çdo sektor të shoqërisë, duke filluar nga amvisëria, industira, automjetet, ndërtesat etj. Për më tepër, shkollimi i gjeneratave të ardhshme të inxhinierëve dhe pajisja me njohuri gjithëpërfshirëse është shumë e rëndësishme për industrinë dhe vet shoqërinë. Duke marrë parasysh kërkesat aktuale dhe ato të

së ardhmes, brenda sektorit të energjisë do të ketë kërkesa të konsiderueshme për inxhinierë të kualifikuar në këtë sektor. Në këtë kontekst, programet BSc dhe MSc në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë synojnë t'i përgjigjen kërkesës të tregut për personel të kualifikuar, madje edhe me kualifikim më të avancuar. Studentët e diplomuar nga Programi Inxhinieri e Energjisë do të kualifikohen për të punuar në prodhim, bartje dhe shpërndarje të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet konvencionale dhe të ripërtërishme të energjisë, si dhe në industritë që ndërlidhen me ofrimin e këtyre shërbimeve. Si pjesë e programit MSc Inxhinieria e Energjisë dhe Mjeditë studentët do të përfundojnë studimet e tyre Master në bashkëpunim të mirëfilltë me sektorin e energjisë, ku do të aftësohen të punojnë edhe si: Inxhinier Proejktant, Udhëheqës të grupeve të caktuara punuese, Team lider, Udhëheqës të sektoreve të ndryshme, e pse jo edhe Menaxher të Departamenteve në fushën e Energjisë dhe Mjeditë.





STRUKTURA E PROGRAMIT

- **Programi i studimit BSc Inxhinieria e Energjisë** ndërthur teorinë dhe praktikën. Programi i studimit është hartuar që të ketë 40 % të mbuluara nga pjesa praktike dhe 60 % nga pjesa teorike.
- **Programi MSc Inxhinier e Energjisë dhe Mjedisit** është i strukturuar në 2 orientime:
 - a) Inxhinieri e Energjisë, dhe
 - b) Inxhinieri e Mjedisit.

Gjithashtu pjesa e kërkimit është e përfshirë në programe, ku studentët përgatiten për të kryer kërkime konceptuale dhe empirike gjatë studimeve në fushat tematike kërkimore në vijim që janë në përputhje me Planin Kërkimor të Fakultetit Inxhinieria e Energjisë.

Fushat e kërkimit në programin BSc të Inxhinierisë së Energjisë janë:

- Burimet e Rinovueshme të Energjisë (Sistemet Diellore, Energjia e Erës, Hidroenergjia dhe Energjia Gjeotermale)
- Teknologjitë e ruajtjes së energjisë
- Pompat e nxehtësisë dhe Energjia Gjeotermale
- Eficienca e Energjisë dhe ndikimi në Mjedis
- Auditimi i Energjisë
- Ekonomia e Energjisë
- Sistemet Elektroenergjetike



MËSIMDHËNIA

Mësimdhënia ofrohet përmes ligjëratave interaktive, seminareve, projekteve, mësimëve individuale dhe punës praktike në laboratorë, e cila i bënë studentët të jenë gjithmonë në hap me trendet e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë.

Zbatimi i lëndëve në praktikë si: Qarqet e Kontrollit Elektrik, Kovertimi i Energjisë Diellore dhe me erë, Prodhimin e Energjisë me Biomassë, Pompat e Nxehtësisë, Energjia Gjeotermale dhe shumë lëndë të tjera, mundëson zgjerimin e njohurive të studentëve në fushën e energjisë.

Gjithashtu përdorimi i softuerëve bashkëkohor, si: Matlab, CAD, GIS, PV Sol, etj krijon mundësinë e rritjes së performancës të inxhinierëve të ardhshëm.

- Në kuadër të mësimdhënies në programin BSc Inxhinieria e Energjisë, organizohen vizitat studimore në industri dhe në sisteme të ndryshme të burimeve të ripërtërishme të energjisë, duke pasuruar njohuritë e studentëve.
- Kurse sa i perket mësimdhënies në programin MSc Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisi, pasi që studentët vijnë kryesisht nga industria dhe në sisteme të ndryshme të burimeve të ripërtërishme të energjisë, pasi që janë punësuar pas studimeve Bachelor pasurojnë njohuritë me lëndë mësimore më të avancuara nga fusha e Energjisë dhe Mjedisit.



INFRASTRUKTURA

- Fakulteti i Inxhinierise së Energjisë ka laborator me të gjitha pajisjet e nevojshme për përgatitjen e inxhinierëve sipas kërkesave të tregut. Laboratoriët mundësojnë zbatimin e njohurive teorike në praktikë.
- Biblioteka e UBT përmban gjithsej 10,000 libra, prej të cilave 488 libra mund të shfrytëzohen në programin BSc Inxhinieria e Energjisë, çka mbulon nevojat e studentëve. Kolegji UBT siguron qasje në mijëra libra elektronikë, artikuj ditar dhe botime të tjera përmes Bibliotekës Elektronike të Kolegjit UBT si EBSCO, Bione, Cambridge Journals dhe JSTOR, Sage, etj.
- Pajisjet e IT të dedikuara për programin BSc Inxhinieria e Energjisë dhe MSc Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisit janë: Serverët, Fotokopjet, printerët, skanerët, Desktop PC, Llaptopët, Projektorët, etj.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Programi Bsc Inxhinieria e Energjisë bazohet në projektin TEMPUS, Projektin për Zhvillim të Planprogrameve për Energjinë Efiçiente, në të cilin UBT është pjesë e konsorciumit. Poashtu edhe programi MSc Inxhinieria e Energjisë dhe Mjedisi bazohet në keto projekte si dhe në projektin ELEMEND.

Përveç kësaj, UBT ka bërë krahasime të ndryshme me programe të ngjashme:

- Hacettepe University, Ankara, Turkey
- POLIS University (AL),
- University Aleksandër Moisiu of Durrës (AL),
- Albanian Constructors Association (AL),
- University of Prishtina (XK),
- University of Montenegro (ME),
- University of Minho (PT),
- Van Hall Larenstein University of Applied Sciences (NL),
- Anhalt University of Applied Sciences (DE),
- Slovak University of Technology in Bratislava (SK)

Fakulteti i Inxhinierisë së Eenergjisë dhe UBT gjithashtu janë edhe anëtar të Bordit Teknik të CIGRE - The International Council on Large Electric Systems dhe kështu u mundëson studentëve dhe stafit që të kenë informacione, bashkëpunime me të gjitha vendet ndërkombëtare anëtare të CIGRE.





NDËRLIDHJA ME INDUSTRI

Me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit me industrinë, Fakulteti Inxhinieri e Energjisë ka lidhur memorandum mirëkuptimi me industrinë, si: Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT Sh.A. Korporatën Energjetike e Kosovës – KEK Sh.A dhe Operatorin e Shpërndarjes në Kosovë – KEDS Sh.A, si dhe me disa kompani private dhe shoqeri civile që operojnë në fushën e Energjisë dhe Mjedisit.

Memorandumet e mirëkuptimit janë lidhur me pikësynim që përmes përvojës praktike të edukimit të përkrahët ngritja e nivelit edukativ dhe profesional të studentëve, përkrahja në krijimin e një ambienti më të volitshëm ekonomik, si dhe përkrahja dhe përgatitja e studentëve për tregun e punës.


Programi BSc Inxhinieri e Energjisë ka lidhur këto Memorandume të Mirëkuptimit me qëllim që të zhvilloj bashkëpunim për interesa të përbashkëta që të promovoj, të përkrahë dhe të ngritë nivelin e bashkëpunimit reciprok, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik. Fakulteti i Inxhinierisë së Energjisë dhe Industria, së bashku, do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, ofrimit të shërbimeve të përbashkëta, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë.

Për çdo vit akademik, Programi BSc Inxhinieri e Energjisë do të përcaktoj numrin e studentëve që do të përfshihen në punë praktike. Praktika e studentëve në Industri do të zgjasë prej dy javë deri në një muaj dhe duhet të realizohet sipas planprogramit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Pas përfundimit të studimeve në Programin BSc Inxhinieri e Energjisë dhe MSc Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedis, studentët do të jenë të kualifikuar kontribuojnë në fusha të ndryshme inxhinierike, si:

- Barte dhe shpërndarje të energjisë
- SCADA sisteme
- Sisteme diellore
- Sisteme me erë
- Hidrocentrale
- Sisteme me Biomassë
- Sisteme gjeotermale
- Sisteme të Ruajtjes së energjisë
- Eficiencë të energjisë
- Menaxhim të energjisë
- Sisteme të ngrohjes dhe ftohjes
- Shoqëri civile lidhur me mbrojtjen e Mjedisit, etj.





UBT - Higher Education Institution

Lagjja Kalabria, 10000 Prishtine, Kosovo

+381 38 541 400

+381 38 542 138